


I. NJËVLEFSHMËRIA E KATEGORIVE TË LEJEDREJTIMIT

- Të gjithë kategoritë e lejedrejtimit janë të vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë AM;
- Lejedrejtimi i kategorisë A2 është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1;
- Lejedrejtimi i kategorisë A është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1 dhe A2;
- Lejedrejtimi i kategorisë B është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë B1, për të drejtuar motomjete, me tre rrota simetrike ndaj aksit gjatësor, me fuqi më të madhe se 15 kw (vetëm në territorin kombëtar), si dhe motomjetet e kategorisë A1 (vetëm në territorin kombëtar), me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç;
- Lejedrejtimi i kategorisë BE, ose B me kodin 96, është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë B;
- Lejedrejtimi i kategorisë C është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë C1 dhe B;
- Lejedrejtimi i kategorisë D është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë D1, C dhe B;
- Lejedrejtimi i kategorisë CE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorisë C1E dhe BE;
- Lejedrejtimi i kategorisë CE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorisë DE me kusht që personi të jetë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë D;
- Lejedrejtimi i kategorisë DE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorisë D1E, CE, C1E dhe BE;
- Lejedrejtimi i kategorisë C1E, CE, D1E, ose DE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve për kategorinë BE.
- Çdo kategori lejedrejtimi mjete me kuti shpejtësie manuale është e vlefshme për të njejtën kategori lejedrejtimi me kuti shpejtësie automatike. Kodi 78 (i kufizuar vetëm për mjetet me kuti shpejtësie automatike) shënohet në lejedrejtimet e lëshuara nga 24 Janari 2017.

➤ *Paraqitja skematike*
Fig. 1



- *Tabela e ekuivalencave të kategorive të lejedrejtimit të lëshuar përpara datës 24 Janar 2017, me kategoritë korresponduese të lejedrejtimit të lëshuar nga kjo datë e në vazhdim*

Tab. 03

Tabela e ekuivalencave	
Kategoritë e modelit të lejedrejtimit të lëshuar nga 01.07.2005 ÷ 23.01.2017	Kategoritë korresponduese
A	AM, A1, A2, A
B	AM, B1, B
C	AM, B, C1, C
D	AM, B, C, D1, D
BE	AM, B, BE
CE	AM, BE, C1E, CE
DE	AM, BE, CE, D1E, DE